ENIO

AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr 2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K 3/VI3-23 **Prot.**
Nr. Dok. 202100625/2 3

Tiranë 18/5 **/2026**

Lënda: Rekomandim për përfundimin e procedurës administrative, shqyrtimi i kërkesave të bashkëpronarëve Agaraj

Drejtuar: Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër
Gjirokastër

Për dijeni: Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
Adresa: Rruga "Dora D'Istra"
Tiranë

Z. Vladimir Agaraj
Lagjja nr. 4, Rruga "Egnatia"
Durrës

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, ka marrë në shqyrtim ankesën e katër bashkëpronarëve trashëgimtarë të familjes Agaraj, për disa problematika gjatë trajtimit të kërkesave të tyre, nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër (DVASHK Gjirokastër), e më konkretisht: mosvënia në dispozicion e certifikatës së pronësisë, mungesë në kthimin e përgjigjeve dhe mospërfundimi i procedurave përkatëse, në lidhje me një pronë të ndodhur në fshatin Çatistër, Gjirokastër. Kjo ankesë i drejtohet 6 (gjashtë) institucioneve, një prej të cilëve edhe institucioni ynë.

Në shpjegimet e tyre bashkëpronarët Agaraj (më poshtë ankuesit) informojnë se disponojnë një sipërfaqe 925 ha "kullotë" me vendndodhje në fshatin Çatistër, Gjirokastër, përfituar me Vendimin e Komisionit të Kthimit të Pronave Gjirokastër nr. 57, datë 27.02.1998, pronë për të cilën janë pajisur edhe me certifikatë pronësie që në datën 25.03.2002.

Me aplikimin nr. 23346, datë 21.03.2017, ankuesit kishin aplikuar pranë ish-ZVRPP Gjirokastër (sot DVASHK Gjirokastër), për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, për trashëgimlënësin Kastriot Agaraj, për pasuritë nr. 470/1, vol.8, faqe 212, zk 1359 (pyll me sipërfaqe 6.097.300 m^2 në fshatin Çatistër) dhe pasurinë nr. 200/2, vol. 1, faqe 1, zk 1359 (kullotë me sipërfaqë 925 ha në fshatin Çatistër), por nuk kishin arritur të merrnin shërbimin e kërkuar.

Më pas ankuesit, nëpërmjet shkresës nr. 519/1 prot., datë 24.03.2021, të Bashkisë Dropull, janë vënë në dijeni se me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08/06/2016 të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", parcelat kullosore nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, "ekonomia kullosore Pogon", mbi të cilat shtrihej pasuria e tyre, kishin kaluar në pronësi të Bashkisë Dropull, ndaj kjo Bashki, ju ka kërkuar ankuesve që nëse disponojnë certifikatë pronësie për këto sipërfaqe, të paraqiten pranë saj.

Duke qenë se ankuesit nuk kishin asnjë njoftim për shpronësimin e pronës së tyre, ata kanë vazhduar komunikimin me DVASHK Gjirokastër, për të përfunduar procedurën e sipërpërmendur (regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë), por nuk kanë arritur të marrin shërbimin përkatës.

Duke mos mundur të zgjidhnin vetë këtë çështje, ankuesit kanë kërkuar ndërhyrjen e institucioneve të tjera shtetërore, ndër të tjera edhe të institucionit tonë, me qëllim përfundimin e procedurës përkatëse për dhënien e certifikatës së pronësisë nga DVASHK Gjirokastër.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit ka konstatuar se ankesa plotësonte të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Për nevoja të shqyrtimit të kësaj çështjeje dhe me qëllim identifikimin sa më të saktë të problematikës së çështjes objekt të hetimit administrativ, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, u kryen këto veprime:

- Me shkresën nr. K3/V13-2 prot., datë 10.05.2021, i jemi drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke i kërkuar të na informonte për:
    1. Korrespondencën që ky institucion kishte pasur me DVASHK Gjirokastër, për konfirmimin e statusit juridik të pasurive, të cilat do kalonin në pronësi të Bashkisë Dropull,
    2. Korrespondencën me Bashkinë Dropull mbi statusin juridik të pasurive: parcelat kullosore nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, "ekonomia kullosore Pogon", të ndodhura në fshatin Çatistër Gjirokastër.

- Me shkresën nr. K3/V13-3 prot., datë 10.05.2021, i jemi drejtuar Bashkisë Dropull, duke i kërkuar të na informonte:

1. Nëse pasuritë: parcelat kullosore nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, "ekonomia kullosore Pogon" të ndodhura në fshatin Çatistër Gjirokastër, bëjnë pjesë në listën e invetarit të pronave të Bashkisë Dropull?
2. Me çfarë akti kanë kaluar në administrim të Bashkisë Dropull këto pasuri?
3. Korrespondencën që ky institucion kishte pasur me DVASHK Gjirokastër, për konfirmimin e statusit juridik të pasurive, të cilat do kalonin në pronësi të Bashkisë Dropull.
4. Korrespondencën me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe gjithë procedurën që është ndjekur nga ana juaj për kalimin në pronësi të Bashkisë Dropull të pasurive të mësipërme.

- Duke qenë se një prej 6 institucioneve që i ishin drejtuar ankuesit, ishte edhe Drejtoria e Përgjithshme e Kadastrës, kjo e fundit, me shkresën nr. 7891/1 prot., datë 20.05.2021, i kthen përgjigje ankuesve dhe për dijeni ndër të tjera edhe institucionit tonë, se: "*Në zbatim të kontratave nr. 6953, datë 24/10/2016 dhe nr. 773/1, datë 28/01/2019,lidhur midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe kontraktorit JV: CSI PIEMONTE &DATECH, është duke u kryer procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullotë të transferuara në pronësi të bashkive në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pjesë e këtyre kontratave është edhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullotë të transferuara në pronësi të Bashkisë Dropull, bazuar në VKM nr. 433, datë 08/06/2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", si dhe në VKM nr. 398, datë13/05/2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08/06/2016 të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive". Përgatitja e vendimeve të Këshillit të Ministrave të lartpërmendura është kryer nga struktura përkatëse në Ministrinë e Mjedisit, sot Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bazuar në të dhënat dhe inventarët e pyjeve dhe kullotave të administruara nga drejtoritë e shërbimit pyjor. Ndërkohë, pjesa e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive kryhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2018"Për kadastrën" dhe Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtyre ligjeve, personi apo subjekti i ngarkuar për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive nuk mund të kryejë regjistrime të titujve të pronësisë për sipërfaqen që krijon mbivendosje me regjistrime të kryera më parë në regjistrat kadastralë apo tituj pronësie të administruara më parë nga drejtoritë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe të zbatojë parimin e përparësisë së titujve të pronësisë sipas përcaktimeve të pikës a) të nenit 36, të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Bazuar në ligjet e lartpërmendura, në kontratat e lidhura midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe kontraktori JV: CSI PIEMONTE & DATECH, është parashikuar se kontraktori ka për detyrë që gjatë procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme pyje dhe kullota të transferuara bashkive të trajtojë edhe aktet e tjera ligjore për dhënien e titujve në pronësi private mbi pasuritë pyje dhe kullota, me qëllim mosregjistrimin e sipërfaqeve që krijojnë mbivendosje me këto akte, si dhe zbatimin e përparësisë së titujve të pronësisë private ndaj listës së pronave shtetërore. Nga shqyrtimi dhe kontrolli i produkteve të fazës së dytë të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive të dorëzuara nga kontraktori i regjistrimit fillestar për Bashkinë Dropull, konstatojmë se pasuria 200/2, ZK 1359, Fshati Çatistër nuk*

është regjistruar në pronësi të Bashkisë Dropull, për shkak se krijon mbivendosje me pronësinë tuaj mbi këtë pasuri, tashmë të regjistruar dhe certifikuar në datë 25/03/2002. Sa më lart, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ju garanton se në veprimtarinë e vet udhëhiqet nga parimet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve kadastrale sipas përcaktimeve të nenit 5, të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën". E drejta juaj e pronësisë fituar me Vendimin nr. 57, datë 27/02/1998 të Ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë Ish-Këshillit të Rrethit Gjirokastër dhe regjistruar mbi pasurinë nr. 200/2, ZK 1359, është e garantuar për sa kohë nuk ka një akt në zbatim të legjislacionit në fuqi apo vendim gjyqësor të formës së prerë që e cenon apo ndryshon atë".

- Në përgjigje të shkresës tonë nr. K3/V13-3 prot., datë 10.05.2021, drejtuar Bashkisë Dropull, kjo e fundit me shkresën nr. 808/1 prot., datë 01.06.2021, na informoi se: *"Sipërfaqja kullosore për të cilën është bërë ankesë, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Dropull me VKM nr. 398, datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016,të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive". Këto pasuri bëjnë pjesë në listën e inventarit të pronave të Bashkisë Dropull, të miratuar me VKB nr. 64, datë 25.10.2018 "Për miratimin e listave me pronat të tipit pyje e kullota që ndodhen në pronësi të Bashkisë Dropull", si dhe VKB Nr. 56, datë 25.09.2019 "Për miratimin e listave të inventarit të pasurive të tipit pyje/kullota të cilat janë pronë e Bashkisë Dropull".*

- Në përgjigje të shkresës tonë nr. K3/V13-2 prot., datë 10.05.2021, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kjo e fundit me shkresën nr. 3206/1 prot., datë 17.06.2021, na informoi se: *"Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në funksion të hartimit të VKM së përditësuar për transferimin e fondit pyjor dhe kullosor publik në pronësi dhe administrim të njësive të qeverisjes vendore, nëpërmjet së cilës rregullohen mangësitë e hasura në VKM nr. 433/2016, ka kërkuar nga bashkitë përditësimin e listave të inventarit me shkresën nr. 8057 prot., datë 9.12.2016. Gjithashtu në vijim, nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Mjedisore, u kontraktua Kompania CSI Piemonte dhe Datech për kryerjen e regjistrimit fillestar të pasurive pyje dhe kullota në pronësi të bashkive. Gjatë punës së tij, Kontraktori ka evidentuar mospërputhje midis listave të transferimit bashkëngjitur VKM 433/2016 dhe hartave pyjore dhe kullosore të përdorura si bazë kryesore përprocesin e regjistrimit. Në këto kushte, me miratimin e Bankës Botërore si donator i Projektit të Shërbimeve Mjedisore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kërkoi nga kontraktori përgatitjen e draftlistave në nivel bashkie, ku të evidentohen konkretisht: (i) parcelat/nënparcelat pyje/kullota të cilat ekzistojnë në hartë por nuk janë përfshirë në VKM; (ii) rastin kur një sipërfaqe është evidentuar nga ortophotot 2015 si pyll, por nuk është e përfshirë as në hartë dhe as në VKM (sipërfaqe që supozohet të jenë të painventarizuara, dmth nuk janë të listuara as në kadastrën pyjore); si dhe (iii) identifikimin e pronave private nëpërmjet dokumentacionit të marrë nga zyrat vendore të ASHK. Ky informacion u kërkua për të mbështetur stafin e pyjeve pranë bashkive përkatëse për përgatitjen e listave të nevojshme për hartimin e VKM së re, duke bërë verifikimet e nevojshme si dhe miratimin e tyre me vendim të këshillit bashkiak. Për sa më sipër, ka qenë detyrë e bashkive (strukturave të shërbimit pyjor në bashki) për të kryer verifikimet dhe përfundimin e një liste inventari të përditësuar, e cila më pas, së bashku me vendimin e këshillit bashkiak, do të bëhej pjesë e VKM nr. 398, datë 13.05.2020".*

- Pas përgjigjeve të mësipërme, me shkresën nr. K3/V13-7 prot., datë 21.07.2021, i jemi drejtuar DVASHK Gjirokastër, duke i kërkuar të na informonte për:

1. Në pronësi të kujt është regjistruar pasuria nr. 200/2, ZK 1359, fshati Çatistër, (aktet me të cilat është regjistruar kjo pasuri).
2. Transaksionet nëse ka mbi këtë pasuri dhe aktet që i shoqërojnë këto transaksione.
3. Korrespondencën që DVASHK Gjirokastër ka pasur me Bashkinë Dropull, për konfirmimin e statusit juridik të kësaj pasurie.

- Në përgjigje të shkresës tonë të mësipërme, DVASHK Gjirokastër me shkresën nr. 3427/1 prot., datë 04.08.2021, refuzoi dhënien e informacionit dhe dokumentacionit institucionit të Avokatit të Popullit, me argumentin se nga institucioni ynë duhej parapaguar tarifë shërbimi, kjo në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale".

- Në përgjigje të sa më sipër, institucioni ynë me shkresën nr. K3/V13-9 prot., datë 20.09.2021, i bëri me dije DVASHK Gjirokastër, se Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shkresën nr. 6480 prot., datë 31.03.2021 drejtuar Drejtorive Vendore dhe Zyrave Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dhe për dijeni institucionit të Avokatit të Popullit, i ka orientuar këto struktura, në lidhje me qëndrimin dhe zbatimin e VKM nr. 389, datë 13.05.2020 "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale", sipas të cilës kërkesat për informacion dhe dokumentacion të Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk janë në kuadër të shërbimeve kadastrale të parashikuara në VKM e sipërcituar, por janë ankesa të bëra pranë këtij institucioni nga individë, grup individësh ose organizata joqeveritare.

- Pas shkresës tonë të mësipërme, DVASHK Gjirokastër me shkresën nr. 3427/3 prot., datë 27.09.2021, na bëri me dije se: "*Nga verifikimi manual dhe në sistem referuar Listeprintimeve nr.2 dhe Regjistrave Kadastrale të fshatit Çatistër, Bashkia Dropull, Gjirokastër, pasuria me nr. 200/2, zk. 1359, nuk na rezulton e regjistruar. Ju lutemi na vini në dispozicion kopje të Certifikatës së Pronësisë, për të bërë evidentimin e pasurisë, pasi është bërë riazhornimi i Zonës Kadastrale dhe mund të jetë bërë ndryshimi i Nr. të Pasurisë*".

- Duke qenë se në korrespondencën e mësipërme ishte përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kjo e fundit me shkresën nr. 16484 prot., datë 04.10.2021, drejtuar DVASHK Gjirokastër dhe për dijeni institucionit tonë dhe ankuesit, i kërkonin institucionit tuaj (pra DVASHK Gjirokastër), të merrte masa për kthimin e përgjigjes, në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 6480 prot., datë 31.03.2021 dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën".

- Në vijim të sa më sipër, institucioni ynë me shkresën nr. K3/V13-12 prot., datë 08.11.2021, i përsëriti kërkesën për informacion DVASHK Gjirokastër, si dhe duke i parashtruar se sa bënte me dije DVASHK Gjirokastër në shkresën nr. 3427/3 prot., datë 27.09.2021, ishte e pabazuar. Kjo për faktin se ankuesit kishin aplikuar pranë ish-ZVRPP Gjirokastër, sot DVASHK, me aplikimin nr. 23346, datë 21.03.2017, për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Kastriot Agaraj për pasuritë nr. 470/1, vol.8, faqe 212, zk 1359 (pyll me sipërfaqe 6.097.300m2 në fshatin Çatistë) dhe pasurinë nr. 200/2, vol. 1, faqe 1, zk 1359 (kullotë me sipërfaqë 925 ha në fshatin Çatistë) dhe referuar Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", regjistrimi i Dëshmisë së Trashëgimisë mbi një pasuri të regjistruar dhe që është lëshuar certifikata e pronësisë, kryhet pas depozitimit të certifikatës origjinale të pronësisë. Sa më

sipër kërkimi i DVASHK Gjirokastër, për depozitim të certifikatës së pronësisë nuk qëndronte, pasi ky akt ishte depozituar së bashku me dëshminë e trashëgimisë gjatë aplikimit nr. 23346, datë 21.03.2017.

- Në përgjigje të shkresës tonë të mësipërme, DVASHK Gjirokastër me shkresën nr. 4685/1 prot., datë 19.11.2021, drejtuar për dijeni edhe ankuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, informoi se: "*Me aplikimin nr.23346, datë 04.09.2017 (e më pas sipas kërkesës nr.4831, datë 28.10.2019), është kërkuar regjistrimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Kastriot Agaraj (në cilësinë e një prej bashkëpronarëve) për pasurinë nr.200/2, vol.1, faqe 1, zk.1359, evidentuar sipas certifikatës së pronësisë lëshuar më datë 25.03.2002 (kullotë me sip. 925 ha në fshatin Çatistë).*
Pas verifikimit të dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë së lartpërmendur si dhe referuar regjistrave kadastrale, ka rezultuar se ka mospërputhje të të dhënave për sa i përket certifikatës së pronësisë së lëshuar (që paqyron vol.1, faqe 1, zk.1359 (produkt·i regjistrimit fillestar), që pasqyron pasuri tjetër me nr.429/12 me sip. 300 m² "vreshtë", afishuar në pronësi të Theodhor Llambro Papa, ndërkohë që referuar të dhënave (numri i pasurisë) sipas regjistrave kadastrale dhe List-printimit III të pasurive për fshatin Çatiste, rezulton se ka vetëm një pasuri me nr.200, që figuron e regjistruar në vol.5, faqe 52, zk.1539 "are", me sipërfaqe 646 m², në pronësi aktuale "shtet".
Në kushtet kur sipas shkresës nr.7448/1 prot., datë 05.11.2018 të ZQRPP-së është rekomanduar vijimi i procedurave të korrigjimit të certifikatës së pronësisë, është dërguar shkresa nr.3951·prot., datë 08.11.2018 drejtuar ATP-së, për konfirmim të Vendimit të KKKP Këshillit Rrethit Gjirokastër nr.57, datë 27.02.1998, në kushtet e mungesës së planvendosjes përkatëse.
Me shkresën nr.10831/1 prot., datë 16.11.2018, nga ana e ATP-së është vënë në dispozicion kopje e njehsuar e Vendimit nr.57 datë 27.02.1998, të KKKP Kësh.Rr.Gjirokastër, si dhe planvendosje e pronës së kthyer bp. Agaraj prej 925 ha, ndodhur në fshatin Çatiste, Bashkia Dropull, duke sqaruar se planvendosja që shoqëron vendimin e mësipërm është në shkalle 1:10000. Për këtë arsye, si dhe duke qenë se zona ku pozicionohet pasuria nuk ishte e azhornuar (referuar hartave kadastrale në shkallë 1:2500 që zyra disponon), është kërkuar plotësimi i dokumentacionit me plan-rilevimi në shkallë 1:2500 (dhe jo plan rilevimi në shkallë 1:25000 siç kanë depozituar me aplikimin e fundit, që evidenton konfiguracionin hartografik të pronës), për të proceduar më pas me regjistrimin përkatës.
Sqarojmë se deri më sot nuk është bërë ky plotësim, çka do të ndihmonte më parë me evidentimin e mbivendosjes me pasuritë e regjistruara në favor të Bashkisë Dropull sipas VKM-së nr. 398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në VKM nr. 433, datë 08/06/2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave... ".
Sa më lart, në funksion të kryerjes së shërbimit të kërkuar nga b.p. Agaraj, nevojitet të procedohet me zgjidhjen e problematikës së mbivendosjes nëpërmjet marrëveshjes, ose rrugës gjyqësore".

- Në përgjigje të shkresës së mësipërme të DVASHK Gjirokastër, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 16484/7 prot., datë 29.12.2021, drejtuar DVASHK Gjirokastër, për dijeni ankuesit dhe katër institucioneve të tjera (një prej të cilave institucioni ynë), e cila pasi bën një përmbledhje të veprimeve të kryera, informon se, citojmë: "*Nga shqyrtimi i kërkesave dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstatojmë se bashkëpronarët Agaraj kanë aplikuar për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Kastriot Agaraj, për të cilën nuk kanë marrë akoma shërbimet kadastrale të kërkuara sipas aplikimit të kryer me nr. 23346, datë04/09/2017. Në përgjigje të kësaj kërkese, me shkresën tuaj me nr. 4758/2 prot., datë 22/11/2021, keni arsyetuar mos*

dhënien e shërbimeve për shkak të pasaktësive në të dhënat e regjistrit të pasurive të paluajtshme me ato të certifikatës së pronësisë të lëshuar më datë 25/03/2002, duke kërkuar nga kërkuesi plotësimin e dokumentacionit edhe me plan-rilevimi, i cili sipas jush do të ndihmonte me evidentimin e problematikës së mbivendosjes me pasuritë e regjistruara në favor të Bashkisë Dropull. Ndërkohë, me shkresën tonë nr. 7891/1 prot., datë 20/05/2021, ju kemi bërë me dije se gjatë procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullotë të transferuara në pronësi të Bashkisë Dropull, bazuar në VKM nr. 433, datë 08/06/2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", si dhe në VKM nr. 398, datë 13/05/2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08/06/2016 të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", kontraktori i regjistrimit fillestar ka marrë në shqyrtim edhe të dhënat e pasurisë së paluajtshme për të cilën është lëshuar çertifikatë pronësie në datë 25/03/2002 në favor të trashëgimtarëve Agaraj, me qëllim shmangien e mbivendosjeve. Produkti i regjistrimit fillestar i përgatitur nga kontraktori është ligjëruar nga ana juaj dhe tashmë gjendet nën administrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastër. Sipas të dhënave të administruara të këtij produkti pasuria e paluajtshme në pronësi të trashëgimtarëve Agaraj është pjesë e tij dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së Gjirokastër mund të pasqyrojë shënimet përkatëse mbi pronësinë sipas përcaktimeve të Ligjitnr.111/2018 "Për kadastrën". Sa më lart, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën" dhe produktin e regjistrimit fillestar të administruar të trajtojë kërkesën e bashkëpronarëve Agaraj dhe të ofrojë shërbimet e kërkuara prej tyre. Pas ofrimit të shërbimeve trashëgimtarëve Agaraj, Drejtoria Vendore e ASHK-së Gjirokastër, në zbatim të përcaktimeve të kreut IV të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të informojë shkresërisht Bashkinë Dropull për përditësimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme që i janë transferuar në pronësi kësaj bashkie. Për sa do të veprohet nga ana juaj të informohet Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së brenda 10 ditëve nga administrimi i kësaj shkrese".

- Në vijim të komunikimeve me ankuesin, për të verifikuar plotësimin e sa i ishte kërkuar atij nga DVASHK Gjirokastër, me shkresën e datës 20.12.2024 ankuesi na informoi se kishte vazhduar korrespondencën me DVASHK Gjirokastër dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së (duke na bashkëngjitur shkresat nr. 02/2 dt.19.01.2022 të DVASHK Gjirokastër; nr.1239/2 prot dt.13.04.2022 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; nr.2287/2 dt.29.04.2022 të DVASHK Gjirokastër; nr. 4064 dt.17.02.2023 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe nr. 938/2 dt.02.03.2023 të DVASHK Gjirokastër), si dhe na informoi se në lidhje me kërkesën e DVASHK Gjirokastër (bërë në shkresën nr. 2287/2 prot., datë 29.04.2022, ku i kërkohej plan rilevimi në formatin shkresor dhe dixhital, përgatitur nga inxhinier topograf i licencuar për pasurinë Kullotë, me sipërfaqe 925 ha), ai nëpërmjet aplikimit nr.8750, datë 07/12/2023 (aplikuar në sistemin Nisa, nga notere Albana Hoti), kishte dërguar planin përkatës të rilevimit, së bashku me dokumentacionin shoqërues (dërguar si në formatin dixhital, ashtu edhe në rrugë postare).

- Pas informacionit të mësipërm të ankuesit, institucioni ynë me shkresën nr. K3/V13-17 prot., datë 27.06.2025, i kërkoi DVASHK Gjirokastër, të na informonte mbi fazën në të cilën ndodhej aplikimi i bashkëpronarëve Agaraj dhe më konkretisht: Cilat ishin arsyet që ende nuk kishte një vendimmarrje përfundimtar për aplikimin e tyre? dhe Çfarë veprimesh

parashikohet të kryheshin dhe në cilat afate konkrete, për përfundimin e shqyrtimit të këtij aplikimi?

- Gjithashtu po pas informacionit të mësipërm të ankuesit, duke qenë se nga shkresat e dërguara nga ai, ndër të tjera u vumë në dijeni se në shkresën e DVASHK Gjirokastër nr. 938/2 prot., datë 02.03.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK dhe për dijeni ankuesit Vladimir Agaraj, citohej shkresa nr. 97, datë 16.02.2022 e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Gjirokastër, sipas së cilës ishte bërë "*kërkesë për regjistrimin e procedurës penale, me nr. 745, të vitit 2020, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër*", institucioni ynë me shkresën nr. K3/V13-18 prot., datë 27.06.2025, i kërkoi Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit, Gjirokastër, të na informonte nëse: kishte ndonjë kërkesë të bërë nga ky institucion, apo ndonjë institucion tjetër shtetëror, që po shqyrtohet nga ndonjë Gjykatë ose Prokurori, që lidhej me bashkëpronarët Agaraj, për pronën e tyre të ndodhur në fshati Çatistër, Gjirokastër.

- Në përgjigje të shkresës tonë të mësipërme, Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit, Gjirokastër, me shkresën nr. 243/1 prot., datë 11.07.2025, na informoi se, citojmë: "*Me shkresën nr.1559 prot., datë 16.12.2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ka njoftuar Avokaturën e Shtetit lidhur me regjistrimin e procedimit penalnr.745/2020, ku po hetohet për dokumentacionin që ka shërbyer për dhënien e vendimit nr.97, datë 19.06.2007 të ZRKK Qarku Gjirokastër dhe vendimit nr.57, datë 27.02.1998 të ish KKKP Qarku Gjirokastër. Bazuar në këtë informacion, Avokatura e Shtetit me qëllim mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit, ka vijuar me shqyrtimin administrativ për verifikimin e ligjshmërisë së pronës së fituar nëpërmjet vendimit nr.97, datë 19.06.2007 të ZRKK Qarku Gjirokastër dhe vendimit nr.57,datë 27.02.1998 të ish KKKP Qarku Gjirokastër në emër të subjekteve Galip dhe Shefqet Agaraj. Në vijim të kësaj procedure, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Gjirokastër me shkresën nr. 253 prot., datë 29.04.2022 drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, bazuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën", ka kërkuar vendosjen e kufizimeve të përkohshme mbi pasuritë e regjistruara në emër të këtyre subjekteve. Avokatura e Shtetit është duke shqyrtuar dokumentacionin e mbledhur nga institucionet në lidhje me ligjshmërinë e vendimit nr.97, datë 19.06.2007 të ZRKK Qarku Gjirokastër dhe vendimit nr. 57, datë 27.02.1998 të ish KKKP Qarku Gjirokastër, në emër të subjekteve Galip dhe Shefqet Agaraj. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre akteve, do të konkludohet mbi veprimet e mëtejshme që do të merren nga Avokatura e Shtetit në lidhje me këtë rast*".

- Në përgjigje të shkresës tonë nr. K3/V13-17 prot., datë 27.06.2025, (cituar më sipër), DVASHK Gjirokastër, me shkresën nr. 2512/1 prot., datë 29.07.2025, na informoi se, citojmë: "*Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të ndodhur në arkivën e DVASHK Gjirokastër rezulton se pasuria Nr.470/1, Vol.8; Fq.212, ZK 1359 Çatistër; është pasuri e llojit "Pyll" e përfituar me VKKP Nr.97, dt.19.06.2007 në favor të trashëgimtarëve të Shefqet e Galip Agaraj, e çertifikuar më datë 06.12.2017, regjistrim i Dëshmisë së Trashëgimisë Nr.1039/533/1,dt.04.08.2017. Nga verifikimi i regjistrave kadastralë, referuar planvendosjes së VKKP Nr.97, dt.19.06.2007 dhe fragmentit të hartës kadastrale digjitale, u konstatua se kjo pasuri ka mbivendosje të pjesshme me pasuritë e paluajtshme 508, 578, 579, etj., të ndodhura në ZK1359, pasuri të regjistruara në pronësi të Bashkisë Dropull, sipas VKM nr.433, dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike". Sipas referencës 024, referencë e regjistrimit të pasurive në pronësi të Bashkisë Dropull, si dhe referenca 025-Urdhër Kufizimi për pasuritë e*

paluajtshme, të cilat krijojnë mbivendosje të pjesshme me pasurinë e përfituar me VKKP Nr.57,dt.27.02.1998. Gjithashtu ju informojmë se pranë DVASHK Gjirokastër është administruar shkresa Nr.253, dt.29.04.2022 e Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit "Kërkesë për vendosje kufizimi mbi disa pasuri" me nr. 2838 Prot., dt.04.05.2022, specifikisht të pasurive të përfituar me VKKP Nr.57, dt.27.02.1998 dhe VKKP Nr.97, dt.19.06.2007 në favor të trashëgimtarëve të Shefqet e Galip Agaraj, ZK1359, të cilat vlerësohet se janë përfituar në mënyrë të padrejtë dhe me dokumentacion të dyshimtë për sa i përket origjinalitetit të tyre. Nga ana e DVASHK Gjirokastër nuk është proceduar me vendosjen e urdhrit të kufizimit, pasi kundrejt kërkesës për kufizim është kërkuar kopje dokumentacioni që konfirmonte dyshimet përkatëse, dokumentacion i cili nuk na është vendosur në dispozicion.
Për të gjitha sa më lart, nuk mund të vijojmë më tej me trajtimin e rastit deri në vendimmarrjen e organeve përkatëse, referuar kërkesës për regjistrimin e procedurës penale me Nr.745 të 2020, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, sipas shkresës Nr.97,dt.16.02.2022 të Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Gjirokastër".

- Duke qenë se si nga komunikimi i mësipërm me DVASHK Gjirokastër, ashtu edhe nga komunikimi me Zyrën Vendore të Avokaturës së Shtetit Gjirokastër, rezultonte se për çështjen në fjalë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, kishte regjistruar procedimin penal, nr. 745, të vitit 2020, institucioni ynë me shkresën nr. K3/V13-21 prot., datë 04.11.2025, i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, të na informonte: 1. Përse bënte fjalë procedimi penal nr. 745, i vitit 2020 dhe a kishte përfunduar ai? Nëse po, cili kishte qenë përfundimi? 2. A ishte shqyrtuar nga ky institucion ndonjë çështje që lidhej me pronën e bashkëpronarëve Agaraj, të ndodhur në fshati Çatistër, Gjirokastër.

- Në përgjigje të shkresës tonë të mësipërme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, me shkresën nr. 7115/1 prot., datë 17.11.2025, na informoi se, citojmë: "*Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal Nr.745, datë 18.12.2020, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, me kërkesën datë 06.02.2024, është kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, pushimi i procedimit penal Nr.745/2020, bazuar në nenin 328/1/b të Kodit të Procedurës Penale. Aktualisht çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. 2. Objekt i hetimit të procedimit penal Nr.745/2020 ka qenë kallëzimi i trashëgimtarëve të familjes Agaraj kundër punonjësve të ish ZVRPP Gjirokastër për mosleshimin e një certifikate pronësie të azhurnuar për pronën e pretenduar kullotë në zonën e fshatit Çatistër, Qarku Gjirokastër".*

Analiza e rastit:
Nga gjithë korrespondenca e përshkruar më sipër, rezulton se ankuesi ka përmbushur të gjitha kërkesat e bëra nga DVASHK Gjirokastër, por sërish nuk arrin të marrë shërbimin për të cilin ka parapaguar rregullisht (jo vetëm në momentin e aplikimit fillestar, por edhe gjatë aplikimeve të tjera, kur ka depozituar dokumentacion shtesë të kërkuar nga DVASHK Gjirokastër). Po nga korrespondenca e zhvilluar, rezulton se prona e ankuesit rezulton pa ndonjë kufizim, ndaj në rrethanat e mësipërme nuk ka asnjë arsye ligjore për ti mohuar atij të drejtën për të marrë dokumentacion përkatës, nga regjistrat shtetëror të regjistrimit të pasurisë të paluajtshme.

Nga hetimi ynë administrativ ka rezultuar se institucionet shtetërore përkatëse që duhet të vepronin me qëllim mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit, kanë qenë të informuara dhe janë investuar për këtë rast, por deri më sot, nuk na ka rezultuar asnjë vendimmarrje nga ana e këtyre institucioneve, që të kufizojë të drejtat e pronësisë së ankuesit. Më konkretisht:

- **Institucioni i Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Gjirokastër**, rezulton të jetë njohur me kohë për këtë rast. Fillimisht rezulton të jetë investuar në vitin 2010, duke kërkuar (me shkresën nr. 74 prot., datë 24.02.2010), pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, kundërshtimin e Vendimit nr. 57, datë 27.02.1998 të ish KKKP Gjirokastër Vendimit nr. 97, datë 19.06.2007 të ish ZRKKP Gjirokastër, por kishte marrë përgjigje negative. Më pas ky institucion (Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastër), me shkresën nr.1559 prot., datë 16.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, është njoftuar lidhur me regjistrimin e procedimit penal nr.745/2020.
Pavarësisht sa më sipër, nuk na rezulton që deri më sot, ky institucion të ketë paraqitur kallëzim penal, ose padi, për rregullimin e problematikave të dyshuara.
Për më tepër ky institucion nuk ka shfrytëzuar as mekanizmat që ofron neni 65, i ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën",[1] sipas të cilit mund të paraqiste ankim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, ndaj mosveprimit të DVASHK Gjirokastër, për vendosjen e kufizimit të përkohshëm mbi pasuritë e regjistruara në emër të ankuesve.
Po kështu konstatojmë një shkelje të theksuar afatesh nga ana e këtij institucioni, pasi nga një anë shprehet se: *"Me shkresën nr.1559 prot., datë 16.12.2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ka njoftuar Avokaturën e Shtetit lidhur me regjistrimin e procedimit penal nr.745/2020"*, ndërkohë që me shkresën nr. 243/1 prot., datë 11.07.2025, informon se:*"Avokatura e Shtetit është duke shqyrtuar dokumentacionin e mbledhur nga institucionet në lidhje me ligjshmërinë e vendimit nr.97, datë 19.06.2007 të ZRKK Qarku Gjirokastër dhe vendimit nr. 57, datë 27.02.1998 të ish KKKP Qarku Gjirokastër, në emër të subjekteve Galip dhe Shefqet Agaraj. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre akteve, do të konkludohet mbi veprimet e mëtejshme që do të merren nga Avokatura e Shtetit në lidhje me këtë rast"*. Pra për rreth 4 (katër) vite, ky institucion nuk arrin të dalë në një konkluzion për rastin konkret.

- Për sa i përket **institucionit të Prokurorisë**, nga hetimi ynë administrativ, rezultoi se bëhet fjalë për një kallëzim të bërë nga ana e ankuesit dhe jo e kundërta. Më konkretisht nga *Njoftimi për përfundimin e hetimeve* dhe *Kërkesa për pushimin e procedimit penal* nr. 745, viti 2020, të dyja të datës 06.02.2024, rezulton se, citojmë: *"Më datë 27.01.2020 shtetasi Ledio Heba ka ushtruar të drejtën e kallëzimit penal me shkrim duke ju drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në kallëzimin e tij shtetasi Ledio Heba denoncon punonjësit e ZVRPP Gjirokastër, të cilët sipas tij kanë kryer veprime korruptive lidhur me praktikën e aplikimit të bërë për ripajisjen me certifikatë pronësie për pronën e llojit "Kullotë", pas vdekjes së njërit prej trashëgimtarëve dhe zëvendësimin e tij me trashëgimtarët ligjorë sipas pjesës takuese në bazë të Dëshmisë së Trashëgimisë"*.

- Për sa i përket komunikimit ndërmjet **DVASHK Gjirokastër** dhe **Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK**, rezulton se kjo e fundit, në cilësinë e organit epror, ka dhënë disa herë orientime dhe udhëzime për mënyrën e trajtimit të rastit, të cilat kanë qenë në favor të ankuesit, (cituara më sipër, por që po i ripërsërisim në vijim), por që nuk janë zbatuar nga DVASHK Gjirokastër:

[1] Neni 65: "*1. Administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të Agjencisë paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative. ...*",

a. Shkresa nr. 7891/1 prot., datë 20.05.2021: " ..... *pjesa e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive kryhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2018"Për kadastrën" dhe Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtyre ligjeve, personi apo subjekti i ngarkuar për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive, nuk mund të kryejë regjistrime të titujve të pronësisë për sipërfaqen që krijon mbivendosje me regjistrime të kryera më parë në regjistrat kadastralë apo tituj pronësie të administruara më parë nga drejtoritë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe të zbatojë parimin e përparësisë së titujve të pronësisë sipas përcaktimeve të pikës a) të nenit 36, të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". ... Nga shqyrtimi dhe kontrolli i produkteve të fazës së dytë të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme të llojit pyll dhe kullot të transferuara në pronësi të bashkive të dorëzuara nga kontraktori i regjistrimit fillestar për Bashkinë Dropull, konstatojmë se pasuria 200/2, ZK 1359, Fshati Çatistër nuk është regjistruar në pronësi të Bashkisë Dropull, për shkak se krijon mbivendosje me pronësinë tuaj mbi këtë pasuri, tashmë të regjistruar dhe certifikuar në datë 25/03/2002. Sa më lart, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ju garanton se në veprimtarinë e vet udhëhiqet nga parimet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve kadastrale sipas përcaktimeve të nenit 5, të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën". E drejta juaj e pronësisë, fituar me Vendimin nr. 57, datë 27/02/1998 të Ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë Ish-Këshillit të Rrethit Gjirokastër dhe regjistruar mbi pasurinë nr. 200/2, ZK 1359, është e garantuar për sa kohë nuk ka një akt në zbatim të legjislacionit në fuqi apo vendim gjyqësor të formës së prerë që e cenon apo ndryshon atë*".

b. shkresa nr. 16484/7 prot., datë 29.12.2021: "*...Produkti i regjistrimit fillestar i përgatitur nga kontraktori është ligjëruar nga ana juaj dhe tashmë gjendet nën administrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastër. Sipas të dhënave të administruara të këtij produkti pasuria e paluajtshme në pronësi të trashëgimtarëve Agaraj është pjesë e tij dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së Gjirokastër mund të pasqyrojë shënimet përkatëse mbi pronësinë, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën". Sa më lart, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër, bazuar në nenin 16, të Ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën" dhe produktin e regjistrimit fillestar të administruar të trajtojë kërkesën e bashkëpronarëve Agaraj dhe të ofrojë shërbimet e kërkuara prej tyre. Pas ofrimit të shërbimeve trashëgimtarëve Agaraj, Drejtoria Vendore e ASHK-së Gjirokastër, në zbatim të përcaktimeve të kreut IV të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të informojë shkresërisht Bashkinë Dropull për përditësimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme që i janë transferuar në pronësi kësaj bashkie. ...*".

c. shkresa nr. 16484 prot., datë 04.10.2021, ku i kërkonte DVASHK Gjirokastër, të merrte masa për kthimin e përgjigjes, në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 6480 prot., datë 31.03.2021 dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën".

- Pas një ankese që një prej ankuesve ka bërë pranë Zyrës së Bashkëqeverisjes, ankesa e tyre është përcjellë për trajtim pranë **Agjencisë Kombëtare të Pyjeve** dhe kjo e fundit ka ngritur një grup pune. Ky grup pune në përfundim të aktit të kontrollit nr. 583/1 prot., datë 04.08.2021, rekomandon se, citojmë: "*1. Bashkia Dropull të fillojë procedurat administrative për korrigjimin e pjesshëm të VKM-së nr.398, dt.13.05.2020, pra "Listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dropull" dhe jo vetëm për parcelat kullosore me Nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11,12,13, 14, të E.P. 'Pogonë", objekt i*

ankimit të familjes Agaraj, por edhe për parcelat pyjore që janë njëkohësisht edhe në pronësi të bashkisë Dropull dhe pyll privat i kësaj familje, të cilat janë trajtuar në këtë material".

- Nga shkresa nr. 437/1 prot., datë 29.02.2024 e **Agjencisë së Trajtimit të Pronave**, vihemi në dijeni se ky institucion nuk ka marrë parasysh kërkesën nr. 74 prot., datë 24.02.2010, të Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Gjirokastër, me objekt: Kundërshtimin e Vendimit nr. 57, datë 27.02.1998 të ish KKP-së Gjirokastër dhe Vendimit nr. 97, datë 19.06.2007 të ish ZRKKP-së Gjirokastër, me arsyetimin se, citojmë: "... *Agjencia e Trajtimit të Pronave në mbështetje të bazës ligjore në fuqi por dhe Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të sipërcituara, nuk ka vijuar në kohë, me trajtimin e kërkesës së zyrës vendore të Avokaturës së Shtetit, për kundërshtimin e vendimit nr. 57, datë 27.02.1998 të ish KKKP-së Gjirokastër dhe Vendimit nr. 97 datë 19.06.2007 të ish ZRKKP-së Gjirokastër, për shkak se në ndryshim nga koha kur kjo kërkesë është bërë, ndërmarrja e këtij veprimi nuk ka patur dhe nuk ka mbështetje ligjore*".

Për të përfunduar me çështjen e mbivendosjes, konstatojmë se qëndrimi i mbajtur nga DVASHK Gjirokastër, është kontradiktor, pasi:

- pranon përparësinë që neni 36, pika "a", i ligjit nr.20/2020, *Parimet dhe kriteret e përditësimit të pronës shtetërore*, i jep pronës private,
  citojmë: "*Parimet që udhëheqin procesin e përditësimit, sipas këtij neni, janë: a) përparësia e titujve të pronësisë private ndaj listës së pronave shtetërore. Në rast se për një pronë apo pjesë prone, që figuron në listën e pronave shtetërore, ekziston titull pronësie i të tretëve, i krijuar sipas legjislacionit të posaçëm, në regjistrin publik do të regjistrohet ky i fundit....*"
- pranon se nuk ekzistojnë kushtet për vendosjen e kufizimit,
  citojmë shkresën nr. 938/2 dt.02.03.2023 të DVASHK Gjirokastër: "*Nga ana e DVASHK Gjirokastër nuk është proceduar me vendosjen e urdhrit të kufizimit, pasi kundrejt kërkesës për kufizim, është kërkuar kopje dokumentacioni që konfirmonte dyshimet përkatëse, dokumentacion i cili nuk na është vënë në dispozicion*".[2]
  Paragraf ky që njëkohësisht tregon se është përmbushur edhe detyrimi tjetër po i nenit 36, pika "a", të ligjit nr.20/2020, për vënien në dijeni të Avokaturës së Shtetit, citojmë: "*...Kur institucioni administrues, njësia e vetëqeverisjes vendore ose ASHK-ja konstaton se titulli i pronësisë private shtrihet mbi pronë publike që nuk mund të tjetërsohej, i kërkon Avokaturës së Shtetit, ngritjen e padisë për njohjen e pronësisë shtetërore dhe pavlefshmërinë e titullit të pronësisë private, pranë gjykatës kompetente;...*",

por sërish DVASHK Gjirokastër: as nuk i lëshon ankuesit dokumentin e kërkuar (certifikatë pronësie) dhe as nuk del me vendim refuzimi (detyrim ky i parashikuar qartë nga neni 26, pika 3, e ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën").[3]

---

[2] Bëhet fjalë për kërkesën nr. 253 prot., datë 29.04.2022 të Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Gjirokastër, drejtuar DVASHK Gjirokastër, me objekt: Kërkesë për vendosje kufizimi mbi disa pasuri – shënim i yni.

[3] Neni 26 - Pamundësia për regjistrim

1. Drejtoria vendore, kur konstaton se akti noterial, vendimi i gjykatës apo akti administrativ që përcakton kalimin e pronësisë ose ndryshimin e statutit të saj është i paqartë, pezullon procedurën dhe njofton kërkuesin. Në këtë rast kërkuesit i kërkohet të përcaktojë qartë informacionin e nevojshëm, brenda një afati 30-ditor. 2. Do të konsiderohet informacion i paqartë, për efekt regjistrimi: a)mungesa e identitetit ose mospërputhje me identitetin në kartelën e pasurisë; b)mospërcaktimi i pronës në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë. ***3. Në rast se pronari nuk arrin të saktësojë këtë informacion, drejtoria vendore e ASHK-së, me urdhër të drejtorit, refuzon regjistrimin.***

Shtojmë se edhe arsyeja tjetër e përmendur në shkresën nr. 938/2 dt.02.03.2023 të DVASHK Gjirokastër, citojmë: "*...lidhur me përparësinë e titujve të pronësisë private ndaj listës së pronave shtetërore, si dhe përcaktimet ligjore sipas nenit 39, pika 3, të ligjit 20/2020, sipas të cilit procedura përkatëse në funksion të përditësimit e përmirësimit, si dhe rregullat për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve do të përcaktohen me VKM. Referuar sa më lart dhe në kushtet kur së fundmi është miratuar VKM 28, datë 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", jemi përpara përcaktimeve të kreut II, pika 6/a, b, c, procedurë e cila nuk mund të fillojë deri në vendimmarrjen e organeve përkatëse referuar kërkesës për regjistrimin e procedurës penale, me nr. 745 të vitit 2020 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, sipas shkresës nr. 97, datë 16.02.2022 të Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Gjirokastër*", nuk qëndron.

Kjo për faktin se siç sqaruam më sipër, siç rezultoi nga hetimi ynë administrativ, (cituar me hollësi më sipër), kallëzimi penal është bërë nga ankuesi ndaj ish ZVRPP Gjirokastër dhe jo nga Avokatura e Shtetit. Pra ky kallëzim jo vetëm nuk përbën pengesë për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit, por përkundrazi, mosveprimi disavjeçar i DVASHK Gjirokastër në rrethanat e reja të sipërpërmendura, parë në një këndvështrim më të gjerë, mund të përmbajë elementë të veprës penale të *Shpërdorimit të detyrës*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- <u>Për sa i përket afateve të shqyrtimit të çështjes</u>

Nga hetimi administrativ na rezulton se janë shkelur afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në trajtimin e aplikimit të bashkëpronarëve Agaraj. Arrijmë në këtë konkluzion bazuar në analizën ligjore në vijim.

Afati fillestar për shërbimin kadastral për të cilin ka aplikuar ankuesi, parashikohet nga neni 29, i ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", *Kërkesa dhe afatet*, sipas të cilit: "*1. Çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkese. .....3.* ***Çdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, <u>trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 21 ditë kalendarike</u>.*** *....*".

Edhe në formularët e aplikimit që ka bërë ankuesi nëpërmjet sistemit online (datat që shënohen në rubrikat: "*Data e aplikimit*", "*Data e përfundimit*"), si në aplikimin fillestar, ashtu edhe në aplikimet plotësuese, në të gjitha rastet kemi konstatuar se afati i shënuar në rubrikën: "*Data e përfundimit*", jo vetëm nuk rezulton të jetë respektuar, por përkundrazi shkelet me periudha kohore, jashtë çdo afati të arsyeshëm.

Ndodhur në kushtet kur ligji i posaçëm që rregullon punën e institucionit tuaj, nuk parashikon afate për përfundimin e procesit administrativ, do t'i referohemi dispozitave të K.Pr.Administrative, i cili në nenin 91, pika 2, parashikon se, citojmë: "*2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë*".

Gjithashtu neni 92, po i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se: "*1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar. 3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit*".

Nga dokumentacioni përkatës i depozituar bashkëngjitur kërkesës së ankuesit, apo edhe nga përgjigjet e kthyera nga DVASHK Korçë, nuk rezulton që të jetë bërë pezullim apo zgjatje e afateve të sipërcituara, ndaj duke qenë se edhe nga komunikimi ynë me institucionin tuaj, nuk rezultoi të kishte dokumentacion tjetër, ndodhemi përpara shkeljes së afateve ligjore, në rastin e trajtimit të kërkesës së ankuesit Vladimir Agaraj.

Ndërkohë sjellim në vëmendje se neni 21, po i K.Pr.Administrative, përcakton se: "*Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim "afatet procedurale", përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit*".

Pra, asnjë organ administrativ/institucion shtetëror nuk mund të fillojë një procedurë administrative dhe ta zvarrisë pafundësisht, por duhet ta përfundojë atë brenda një afati të arsyeshëm ligjor.
Qëllimi i vendosjes së afateve ligjore dhe respektimi i tyre, është përfundimi sa më shpejt i procedurës administrative dhe brenda një kohe të arsyeshme, në respektim të procesit të rregullt ligjor.

Nga dokumentacioni i administruar në kuadër të këtij hetimi administrativ, rezulton se ndërmjet ankuesit dhe DVASHK Gjirokastër, ka pasur një korrespondencë të vazhdueshme, ç'ka na jep të kuptojmë se DVASHK Gjirokastër ka qenë në dijeni të ankesave për vonesa në mospërfundimin e shqyrtimit të aplikimit, por siç përmendëm më sipër, nuk jep ekzistencën e ndonjë shkaku ligjor, i cili do të mund të justifikonte këtë situatë. Shtojmë se ankuesi pasi ka shteruar ankimet administrative, i është drejtuar edhe organit të Prokurorisë, duke bërë kallëzim penal.

Respektimi i afateve gjatë procesit administrativ përbën bazën e sigurt të çdo rendi juridik ligjor e demokratik pasi:
- procesi administrativ përbën hallkën e parë dhe më të prekshme të procesit ligjor, përmes të cilit qytetari në përpjekje për të fituar apo mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij përballet me administratën shtetërore dhe vendore.
- procesi administrativ tregon qartë cilësinë e aksesit në drejtësi, pasi gjatë këtij procesi çdo shtetas kupton dhe percepton më qartë mënyrën se si jepet drejtësia. Mungesa e afateve të arsyeshme në përfundimin e procesit administrativ e bën të paplotë këtë angazhim, duke cenuar drejtpërdrejt të drejtën për një proces të rregullt ligjor.
- procesi administrativ duke cenuar procesin e rregullt ligjor, ka mohuar garancinë për çdo shtetas ndaj veprimeve të paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe detyrim për këto të fundit që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, gjatë veprimtarisë së tyre administrative.
-detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 i saj, e cila kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentet e brendshëm të një shteti.
Në respektim të këtyre parashikimeve, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues, ku konkretisht neni 4, paragrafi 1, parashikon se: "*Liria, prona dhe të*

drejtat e njohura me Kushtetutë dhe ligj, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor".

Referuar rastit të paraqitur nga ankuesi, shtojmë se organi administrativ, që duhet të zbatojë detyrimet normative (ligjore dhe nënligjore), përfshirë edhe detyrimin për të dalë me vendim përfundimtar, është DVASHK Gjirokastër.

Problematika në lidhje me këtë ankues, për sa kohë që nuk ka një vendim administrativ lidhur me trajtimin e kërkesës së tij, prek të drejtat e tij për t'iu trajtuar çështja brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, por prek edhe të drejtën e tij për t'u informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore. Këto janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në:

- Nenin 23, pika 2, parashikon: "*2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...*".
- Neni 42, pika 1, parashikon: "*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*".
- Neni 15, pika 2, parashikon se: "*organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*".

Veprimet (apo mosveprimet) e mësipërme, siç përmendëm edhe më sipër, e vendosin institucionin tuaj përpara shkeljes së procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e këtij procesi administrativ, ndaj vlerësojmë se institucioni juaj duhet të përmbushë detyrimet ligjore në lidhje me procedurat, duke shmangur vonesat e panevojshme, që mund të jenë shkaktuar nga: inercia, neglizhenca apo zvarritja e qëllimshme e procesit, pasi Institucioni i Avokatit të Popullit ka mandat të vlerësojë jo vetëm veprimet e paligjshme të administratës publike por edhe veprimet e parregullta të saj.

Gjithashtu si ligji nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 111/2018 "Për kadastrën", Kodi i Procedurave Administrative, apo edhe akte të tjera normative, parashikojnë detyrime për DVASHK-të, që të jenë transparente në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, pasi krahas mundësimit të së drejtës së informimit, ato duhet të ndërmarrin veprime konkrete dhe të zbatojnë programe efikase informimi (si për aplikuesit, ashtu edhe për publikun e gjerë), lidhur me efektet e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të këtij institucioni.

Informimi dhe ndihma që i duhet dhënë shtetasve, janë jo vetëm detyrime ligjore (Kodi i Procedurave Administrative, neni 10 - *Parimi i dhënies së ndihmës aktive*: "*1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. 2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik. 3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit*"), por në vlerësimin e institucionit

tonë edhe elementë shumë të rëndësishëm, për garantimin e përfundimit me sukses të proceseve kalimtare të pronësisë.

Mospërfundimi i procesit nga ana e institucionit tuaj, nuk gjen asnjë justifikim ligjor apo të arsyeshëm dhe mbi të gjitha cenon edhe parimin e sigurisë juridike në një shtet demokratik. Kjo për arsye se parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe jo vetëm pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Institucioni ynë duke pasur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë, si në raport me garantimin e të drejtës së pronësisë së shtetasve, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik të vendit, në rastet kur konstaton vonesa në trajtimin e praktikave, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo afati të arsyeshëm, rekomandon marrjen e masave sistemike, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve konkrete dhe jo të lihen pa trajtuar kërkesat e shtetasve, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo *afati të arsyeshëm.*

Nuk do të ndalemi në analizën me hollësi të konceptit të *afatit të arsyeshëm*, por për këtë rast konkret jemi të mendimit se kjo vonesë nuk mund të konsiderohet aspak si e arsyeshme. Gjithashtu mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve (pavarësisht llojit të shërbimit kadastral) brenda afateve ligjore dhe/ose atij të arsyeshëm, në varësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjnë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustifikuar e procedurës administrative.

Në analizë të parashikimeve të mësipërme, rezulton se ankuesit, për shkaqe të pavarura nga ata, nuk arrijnë të marrin një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që kanë respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ata nuk mund të gëzojnë plotësisht pronën, për të cilën kanë edhe certifikatën e pronësisë, apo edhe të drejta të tjera që i garanton legjislacioni në fuqi (tjetërsimi juridik i pronës së tyre).
Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së këtyre pronarëve, kufizon liritë dhe të drejtat e tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

Institucioni ynë përsërit se shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga: *humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike*, e deri tek *rreziku i përballjes së organeve të administratës shtetërore me padi civile për dëm jashtëkontraktor*, që mund t'i jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Nisur nga konstatimi i tejkalimit të afateve ligjore të sipërcituara për këtë rast, në mbështetje të nenit 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: "*3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.....*", si dhe nenit 21, germa b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, sipas të cilit: "*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:... b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*"

REKOMANDOJMË

Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër të përfundojë menjëherë procedurën administrative, shqyrtimi i aplikimit të bashkëpronarëve Agaraj dhe lëshimin e dokumentit përkatës për të cilin kanë aplikuar.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, "*Detyrimi i organeve të administratës për t'ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit*", sipas të cilit: "*Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij*", lutemi të na vini në dijeni mbi zbatimin e këtij Rekomandimi, brenda 10 ditëve nga e nesërmja e mbërritjes së kësaj shkrese.

Duke ju falënderuar paraprakisht,

KOMISIONERE

Erinda MELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT